

Personat me aftësi të Kufizuara dhe Covid-19

Paketë burimore për reagimin gjatë
pandemisë dhe situatave të tjera të krizave
humanitare

Ky material u përgatit nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni në adresën:
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
Rr. Bogdani, Nr. 1, Tiranë
Tel.: + 35542269426;
E-mail: adrf@albmail.com
www.adrf.al

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.

Tiranë, Dhjetor 2020

Kjo paketë burimore është përgatitur në kuadrin e projektit “ COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar”, të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje
2. Si ndikon COVID-19 tek personat me aftësi të kufizuara?
3. Korniza ligjore që mbështet ndërhyrje gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufizuar në menaxhimin e situatave të rrezikut nga fatkeqësitë.
4. Ndërhyrje sektoriale dhe rekomandime për masa gjithëpërfshirëse për parandalim dhe rikuperim të personave me aftësi të kufizuara nga COVID -19.
5. Hapat kryesore për të garantuar ndërhyrje sektoriale dhe masa gjithëpërfshirëse për parandalim dhe rikuperim të personave me aftësi të kufizuara nga covid -19.
6. Burime të tjera informacioni

1. HYRJE

Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Opsional i saj (CRPD, 2006, A/RE S/61/106) përcakton se personat me aftësi të kufizuara “përfshijnë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efikase në shoqëri mbi një bazë të barabartë me të tjerët”.

Organizata Botërore e Shëndetit¹ vlerëson se rreth 15% e popullsisë së botës, ka një aftësi të kufizuar. Në Shqipëri, regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 zbuloi se 6.2 përqind e popullsisë mbi 15 vjeç ka një formë të aftësisë së kufizuar. Ndërsa, statistikën më të fundit të MShMS, tregojnë se ka 144 135 persona me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Në situatat e krizave dhe emergjencave humanitare, incidenca e aftësisë së kufizuar është zakonisht e lartë sepse një pjesë e madhe e njerëzve kanë dëmtime, mungesë akses në shërbime mjekësore, dhe përballen me pengesa në mjedisin e tyre.

Në situatat e emergjencave dhe krizave humanitare, personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të njëjtat të drejta dhe nevoja bazë si të tjerët, si dhe përballen me të njëjtat sfida. Megjithatë, ata përballen me barriera të shumta të mëtejshme. Ata përballen me rreziqe të veçanta mbrojtjeje, duke përfshirë këtu një rrezik të shtuar dhune, shfrytëzimi dhe abuzimi, dhe nivele të larta të stigmatizimit. Ata kanë vështirësi për të patur akses në asistencën humanitare, arsim, mjetet e jetesës, kujdes shëndetësor dhe shërbime të tjera. Atyre mund t’u mohohen disa të drejta ligjore, dhe shpesh përjashtohen nga proceset vendim-marrëse dhe mundësitë për qenë në nivele drejtuese.

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë një grup homogjen. Ata përballen me forma të shumta dhe të ndërthurura diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar por gjithashtu për shkaqe të tjera, të cilat mund të çojnë në situata përjashtuese.

¹ Raporti i OBSH-sw pwr aftësinw e kufizuar, 2011

Kriza globale e COVID-19 thelloi pabarazitë, duke bërë me evidente përjashtimin dhe duke nënvizuar se puna për përfshirjen e aftësisë së kufizuar është domosdoshmëri.

4 janë drejtimet kryesore të ndërhyrjes, për ta bërë reagimin gjithëpërfshirës edhe ndaj personave me aftësi të kufizuara.

1. Të sigurohet integrimi i personave me aftësi të kufizuar në të gjitha masat për parandalimin nga infektimi dhe për shërimin nga COVID-19. Është i nevojshëm një kombinim i masave të përgjithshme me masa specifike për personat me aftësi të kufizuara, për të siguruar përfshirjen sistematike të tyre.

2. Të sigurohet akses në informacion, në shërbime dhe programe gjatë fazës së parandalimit dhe kurimit nga COVID-19. Aksesueshmëria është thelbësore për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në reagimin e menjëhershëm shëndetësor dhe socio-ekonomik ndaj COVID-19. Nëse informacioni për shëndetin publik, mjedisi i ndërtuar, komunikimet dhe teknologjitë, dhe mallrat dhe shërbimet nuk janë të arritshme, personat me aftësi të kufizuara nuk mund të marrin vendime të nevojshme, të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të izoloohen ose karantinohen në mënyrë të sigurt, ose të kenë qasje në shërbime shëndetësore dhe publike në baza të barabarta me të tjerët.

3. Të sigurohet konsultim me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në të gjitha fazat e ndërhyrje për parandalimin dhe shërimin nga COVID-19. Shumë persona me aftësi të kufizuara kanë përvoja në përballimin e situatave të izolimit dhe mund të ofrojnë modele të vlefshme për situatën aktuale. Perspektivat dhe përvojat e jetuara të personave me aftësi të kufizuar kontribuojnë në qasje të reja dhe zgjidhje inovative ndaj sfidave.

4. Të përcaktohen mekanizmat përgjegjës për të siguruar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në reagimin ndaj COVID-19. Qeveritë, donatorët, agjensitë e Kombeve të Bashkuara dhe aktorë të tjerë duhet të krijojnë mekanizma për të monitoruar që investimet arrijnë tek personat me aftësi të kufizuara. Disegregimi i të dhënave me tregues specifik për personat me aftësi të kufizuara, është thelbësor për të siguruar planifikim, zbatim dhe monitorim të gjithëpërfshirjes.

2. SI NDIKON COVID-19 TE PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA?

Personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh të infektimit me COVID-19. Ata mund të kenë pengesa për zbatimin e masave themelore të mbrojtjes siç është larja e duarve dhe mbajtja e një distancimi fizik për disa arsye që lidhen me nivelin e dëmtimit, përfshirë pamundësinë apo nevojën për ndihmë për të larë duart, nevojën për kontak fizik me persona të tjerë për të marë mbështetje. Mungesa e aksesit në informacionin që ofrohet për shëndetin publik, për shkak të mungesës së ofrimit të tij në formate alternative, përfshirë përkthimin në gjuhën e shenjave, audio, në formate të thjeshtuara, përmes mesazheve me piktograme etj.; vendosja në institucione rezidenciale të cilat shpesh janë të mbipopulluara dhe nuk ofrojnë kushte të higjenës, të distancimit dhe të kujdesit; mungesa e aksesueshmërisë fizike në ambiente shëndetësore, në ambientet që ofrojnë paketa higjieno sanitare, sic janë farmacitë etj, janë gjithashtu faktorë që rrisin riskun për personat me aftësi të kufizuara për tu infektuar nga COVID-19. Ndërkohë personat me aftësi të kufizuara kanë më shumë rrezik për përkeqësim të gjëndjes shëndetësore dhe humbje të jetës nga COVID-19, për shkak se ata kanë kërkesa më të mëdha për kujdes shëndetësor dhe shpesh rezultate më të dobëta të trajtimit të tyre. Për shembull, ata janë më të ndjeshëm ndaj sëmundjeve bashkëshoqëruese siç janë problemet e mushkërive, diabetit, sëmundjet e zemrës dhe mbipesha, të cilat mund të përkeqësojnë rezultatin e infeksionit nga COVID-19.

Personat me aftësi të kufizuara janë në risk më të madh për diskriminim, në lidhje me qasjen/aksesin në procedurat e nevojshme për kujdes shëndetësor, të domosdoshme për të trajtuar e për të shpëtuar jetën gjatë shpërthimit të COVID - 19. Në disa vende, vendimet për kujdes shëndetësor, përfshirë protokollet e grupeve të synuara (p.sh. shtretërit e kujdesit intensiv, ventilatorët), nuk janë bazuar në një prognozë individuale, por më tepër në kriterë diskriminues, siç janë mosha ose supozimet për cilësinë ose vlerën e jetës bazuar në aftësinë e kufizuar. Për më tepër, kujdesi shëndetësor, rehabilitimi dhe teknologjitë ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara, gjithashtu mund të kufizohen për shkak të presionit të shtuar në sistemet e kujdesit shëndetësor.

Personat me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të pafuqishëm ndaj pasojave socio-ekonomike të COVID-19 dhe masave për kontrollin e pandemisë. COVID-19 ka implikime afatshkurtra por edhe afatgjata për personat me aftësi të kufizuara në shumë fusha të jetës:

- *Ndikimi në punësim dhe mbrojtje sociale.* Tashmë që përballemi me rrezikun e shtimit të papunësisë, personat me aftësi të kufizuara kanë më shumë të ngjarë të humbasin punën e tyre krahasimisht me personat e tjerë, si edhe të kenë vështirësi më të mëdha kur kthehen në punë. Në shumicën e vendeve, sistemet e mbrojtjes sociale ofrojnë pak mbështetje për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, ato kanë gjithashtu shumë më pak akses në sigurimet shoqërore. Kërkesa e rritur për kujdes pa pagesë dhe punë shtëpiake në kontekstin e pandemisë thëllon pabarazitë tashmë ekzistuese, të cilat mund të përkeqësohen për gratë me aftësi të kufizuara.

- *Ndikimi në arsim.* Ndërsa shifra të besueshme për studentët me aftësi të kufizuara nuk janë ende të disponueshme, ka të ngjarë që kriza e tanishme ka përkeqësuar përjashtimin e tyre nga arsimi. Siç u vu re, për shkak të ndikimit të COVID-19 tek fëmijët, studentët me aftësi të kufizuara, ishin të pakët ose nuk përfituan aspak nga zgjidhjet e mësimin në distancë. Mungesa e mbështetjes, mungesa e qasjes në internet, programet e paarritshëm dhe mungesa e materialeve mësimore, ka thëlluar hendekun për studentët me aftësi të kufizuara. Mos përshtatja e programeve të trajnimit dhe formimit profesional, ka të ngjarë të ketë efekte shumë të gjera tek të rinjtë me aftësi të kufizuara, të cilët përballen me një mori pengesash për të hyrë në tregun e punës.

- *Ndikimi në shërbimet mbështetëse.* Për shumë njerëz me aftësi të kufizuara, qasja në shërbime mbështetëse është thelbësore për një jetë të sigurt, të shëndetshme dhe të pavarur. Masat për të parandaluar përhapjen e COVID-19 kanë rezultuar në ndërprerje të konsiderueshme të shërbimeve, sistemeve mbështetëse dhe rrjeteve joformale, të tilla si ndihmësit personal, përkthyesi i gjuhës së shenjave etj. dhe mbështetja psikosociale. Ndikimi ekonomik i COVID-19 mund të çojë gjithashtu në zvogëlim më të madh të shërbimeve ekzistuese në periudhën pas pandemisë.

• *Ndikimi në dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara*. Situata e krijuar nga COVID-19, tregoi për një rritje të konsiderueshme të dhunës në familje, për shkak të masave të bllokimit, gjë që ka një ndikim të veçantë mbi gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Duke pasur parasysh që si fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara janë në rrezik shumë më të lartë të dhunës sesa bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara, mund të supozohet se COVID -19 ka shtuar më tej rrishtin që ata të jenë të dhunuar.

3. KORNIZA LIGJORE QË MBËSHTET NDËRHRYJE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR NËMENAXHIMIN E SITUATAVE TË RREZIKUT NGA FATKEQËSITË.

Ka një kuadër të politikave ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilat janë të disponueshme për të ndihmuar/për të udhëzuar zbatimin efektiv të menaxhimit të situatave të rrezikut nga fatkeqësitë duke i bërë ato gjithëpërfshirëse sa i përket aftësisë së kufizuar.

Midis tyre janë Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KNDPAK/CRPD), Samiti Botëror Humanitar, Marrëveshja për Ndryshimin e Klimës në Paris, Habitat III dhe Agjenda e Re Urbane, Ligji Shqiptar “Për mbrojtjen civile”

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara KDPAK/ UNCRPD

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara u miratua në Dhjetor 2006 dhe u ratifikua nga qeveria shqiptare në Dhjetor 2012. Konventa shënon një "ndryshim të paradigmës" për sa i përket qëndrimeve dhe qasjes ndaj personave me aftësi të kufizuara, duke kaluar nga trajtimi i personave me aftësi të kufizuara si "objekte" të bamirësisë, trajtimin mjekësor dhe mbrojtjes sociale drejt trajtimit të tyre si "subjekte" me të drejta, të cilët janë në gjendje t'i kërkojnë ato të drejta dhe të marrin vendime për jetën e tyre bazuar në pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar, si dhe duke qenë anëtarë aktivë të shoqërisë.

Neni 5 parashikon të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim. Masat emergjente dhe legjislatoni i miratuar gjatë krizave të emergjencës duhet të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara nuk diskriminohen në asnjë aspekt të jetës së tyre.

Neni 10 detyron shtetin të mbrojtë të drejtën e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Vendimet për shpërndarjen e burimeve të shpëtimit të jetës nuk duhet të bazohen në shkaqe

që lidhen me aftësinë e kufizuar. Duhet të ndiqet Udhëzuesi Etik i Shoqatës Botërore të Mjekësisë. 'Në zgjedhjen e pacientëve që mund të shpëtohen, mjeku duhet të marrë në konsideratë vetëm statusin e tyre mjekësor dhe përgjigjen e parashikuar ndaj trajtimit dhe të përjashtojë çdo konsideratë tjetër bazuar në kriteret jo-mjekësore. '

Neni 11 e detyron shtetin të garantojë sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata rreziku, konflikti, emergjencash humanitare ose të katastrofave natyrore. Shtetet duhet të sigurojnë që ligjet, politikat dhe masat e shpërndarjes së burimeve të kryhen në atë mënyrë që të mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga rreziku i infeksionit dhe vdekjes.

Neni 19 parashikon të drejtën për të ushtruar zgjedhje dhe kontroll mbi atë se ku dhe me kë të jetojë, të marrë pjesë në komunitet në baza të barabarta si të tjerët dhe të ketë akses në çdo mbështetje të nevojshme për t'iu mundësuar personave me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur. Pa planifikim dhe pa burimet e domosdoshme, kërkesat aktuale për distancimin shoqëror do të ndikojnë në mënyrë disproporcionale personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në ambiente rezidenciale shëndetësore dhe ato të përkujdesjes sociale.

Neni 25 siguron të drejtën për standardet më të larta të arritshme të shëndetit për personat me aftësi të kufizuara. Ambjentet dhe pajisjet shëndetësore të disponueshme për publikun e gjerë duhet të jenë njësoj të disponueshme dhe të arritshme për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 32, njih rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për të adresuar kapacitetet e kufizuara të disa shteteve për t'iu përgjigjur situatave të rrezikut dhe krizave humanitare.

Agjenda 2030 – Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

Axhenda 2030 thekson që të gjitha shtetet kanë përgjegjësi të respektojnë, mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut pa diskriminim të çfarëdo lloji, përfshirë edhe në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. 17 Qëllimet e saj ofrojnë një kornizë të daaktësuar ndërkombëtarisht për veprim për zhvillim kombëtar dhe global për periudhën deri në vitin 2030. Qëllimi 9 është veçanërisht i rëndësishëm për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në aksione humanitare. Ai pohon nevojën për të promovuar shoqëri paqësore dhe

gjithëpërfshirëse për zhvillimin e qëndrueshëm, sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Qëllimi 9 u bën thirrje shoqërive të ndërtojnë infrastrukturë të shëndoshë, veçanërisht në zonat e prekura nga katastrofat. Qëllimet 11 dhe 13 shërbejnë për të kujtuar se asnjë çështje, përfshirë parandalimi dhe lehtësimi nga katastrofat, nuk mund të kuptohen ose adresohen në mënyrë efektive, nëse janë të izoluar.

Korniza Sendai për Uljen e Rrezikut në Raste të Fatkeqësive 2015-2030

Korniza Sendai, e miratuar nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015, synon të zvogëlojë rreziqet nga katastrofat dhe humbjen e jetës dhe pasurive. Ajo promovon një qasje të gjithanshme të një shoqërie që përfshin personat me aftësi të kufizuara. Korniza promovon përfshirje, aksesueshmëri, dhe zbatimin e standardeve të projektimit universal, dhe pranon që personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre kanë një rol kritik për të luajtur në të gjitha fazat e planifikimit të uljes së rrezikut nga katastrofat.

Samiti Botëror Humanitar (2016) dhe Agjenda për Angazhimet e Njerëzimit

Situata e personave me aftësi të kufizuara u diskutua gjatë Samitit Botëror Humanitar dhe një numër organizatash u prononcuan për të përfshirë personat me aftësi të kufizuara në aksionin humanitar. Shtetet Anëtare, organizma të Kombeve të Bashkuara, organizatat joqeveritare(OJQ) dhe të tjerë pjesëmarrës në këtë takim, pranuan që politikat humanitare, procedurat dhe programet që kërkojnë të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara duhet të forcohen dhe të kenë qasje sistemike. Karta e Përfshirjes së Personave me Aftësi të Kufizuara në Veprime Humanitare, e prezantuar gjatë Samitit, përcakton pesë angazhime për veprim: mosdiskriminim; pjesëmarrjen; politika gjithëpërfshirëse; përgjigje/reagime dhe shërbime gjithëpërfshirëse; dhe bashkëpunim dhe koordinim.

Ligj Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

Neni 14, pika 3 e këtij ligji parashikon që planet për emergjencat civile marrin në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të

shtresave në nevojë dhe grave. Ndërsa neni 50, pika 2 parashikon që llojet e sinjaleve të alarmit për njoftimin e hershëm të popullsisë për marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen nga fatkeqësitë, në varësi të shkallës së rrezikut dhe të shtrirjes territoriale, testohen, me qëllim që të jenë të komunikueshme për kategoritë e personave: a) me vështirësi në dëgjim, me anë të shenjave pamore; b) me vështirësi në shikim, me anë të sinjaleve akustike dhe të prekshme; c) me kufizime intelektuale, në formate të thjeshtuara, përmes mesazheve me piktoگرامe ose gjuhë e thjeshtë në media. Neni 57, që përcakton të drejtat e shtetasve, parashikon që shtetasit kanë të drejtë të informohen në mënyrë të përhershme dhe të përditësuar për risqet nga fatkeqësitë, si edhe për masat e nevojshme dhe ato të marra për menaxhimin e tyre. Pika 2 e këtij neni parashikon që shtetasit kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e jetës së tyre dhe të pronës nga strukturat e mbrojtjes civile, sigurimin e kushteve për jetesë kur janë prekur nga fatkeqësia, deri në momentin e rikthimit në gjendje normale, duke ju dhënë prioritet shtetasve më të rrezikuar, si fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë. Ndërsa neni 59 përjashton nga detyrimi për t'u angazhuar në operacione për parandalimin dhe përbalimin e fatkeqësive, mes disa kategorive edhe personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për ta.

4. NDËRHRYJE SEKTORIALE DHE REKOMANDIME PËR MASA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR PARANDALIM DHE RIKUPERIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NGA COVID -19.

Çdo gjë që bëjmë gjatë dhe pas krizës COVID-19 duhet të ketë një fokus të fortë në ndërtimin e ekonomive dhe shoqërive më të barabarta, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme përballë pandemive dhe shumë sfidave të tjera globale me të cilat përballemi.

Për të ndërtuar komunitete të barabarta, gjithëpërfshirëse dhe fleksibël është e rëndësishme që:

1. Të angazhohen personat me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e ndërhyrjes: Kur mbështesin iniciativat lokale, qeveritë, organizmat e KB, donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të promovojnë, financojnë dhe monitorojnë përfshirjen e

personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e projektimit dhe zbatimit të masave përkatëse.

2. Të vlerësohen me prioritet personat me aftësi të kufizuara në përgjigjen socio-ekonomike: Modelet dhe propozimet ekonomike kombëtare dhe lokale duhet të rishikohen në mënyrë kritike për të identifikuar boshllëqet që ndikojnë në mënyrë disproporcionale personat me aftësi të kufizuara duke parashikua kosto e investime specifike që garantojnë përfshirjen e aftësisë së kufizuar.

3. Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara: Duhet të vendosen masa për të lehtësuar qasje në kohë në shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, të tilla si transporti në institucionet e kujdesit shëndetësor, qasja në interpretin e gjuhës së shenjave në spitale, si dhe blerjen e mallrave, ilaçeve dhe shërbimeve. Shërbimet shëndetësore thelbësore, përfshirë shëndeti seksual dhe riprodhues, duhet të jenë të arritshme — për shembull, duke siguruar që programet e telemedicine të jenë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë mënyra të ndryshme të komunikimit.

Ndërhyrjet e shëndetit mendor duhet të jenë përfshirëse për personat me aftësi të kufizuara pasi ankthi, bllokimet, izolimi dhe konsumi i informacionit, humbja e mjeteve të jetesës dhe sistemeve mbështetëse për shkak të ndikimit të pandemisë, ndikon në shëndetin mendor të të gjithë njerëzve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Siç është vënë re, gjatë COVID-19, tek personat e moshuar, masat e distancimit fizik, që kufizojnë vizitorët dhe aktivitetet e grupit në institucion, gjithashtu mund të ndikojnë negativisht në shëndetin mendor dhe fizik dhe në mirëqenien e tyre. Mbështetja për shëndetin mendor dhe përkrahja psikosociale duhet të jenë të arritshme dhe të mos diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.

4. Ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme të mbrojtjes sociale edhe për personat me aftësi të kufizuara: Pagesat që lidhen me aftësinë e kufizuar, kostot shtesë duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të jenë në përputhje me skemat e punësimit dhe të ndihmës sociale që synojnë sigurinë themelore të të ardhurave. Kjo mund të bëhet duke rritur pagesat që lidhen me përfitimet e aftësisë së kufizuar; siguruar përftime që lidhen me skemën e ndihmës ekonomike edhe për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë për anëtarët e familjes që duhet të ndërpresin

punën për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara; dhe vendosjen e pagesës elektronike apo shpërndarjen në shtëpi të pagave dhe sendeve /mallrave thelbësore ushqimore dhe jo-ushqimore.

5. Adresimi i situatës specifike të punonjësve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët: Mund të ketë persona me aftësi të kufizuara që vazhdojnë të punojnë, që kanë nevojë për mbrojtje specifike ose rregullime për të qëndruar të sigurt gjatë pandemisë. Në çdo kohë është e rëndësishme që punëdhënësit dhe vendet e punës të ofrojnë ambiente të arritshme dhe rregullime të arsyeshme në vendin e punës bazuar në nevojat individuale. Personave me aftësi të kufizuara që zotërojnë biznes ose punojnë në ekonominë joformale mund t'u duhet ndihmë e veçantë për të qenë në gjendje të ruajnë jetesën e tyre. Paketat stimuluese, përfshirë ato që do të promovojnë trajnime dhe punësim, duhet të përfshijnë në mënyrë të qartë personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi, si dhe gratë dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara në veçanti.

6. Garantimi i vazhdimësisë së arsimimit të personave me aftësi të kufizuara: Duhet marrë masa që mësimi në distancë të jetë i arritshëm, dhe gjithëpërfshirës për nxënësit/studentët me aftësi të kufizuara. Kjo mund të përfshijë sigurimin e pajisjeve të specializuara për të mbështetur mësimin e tyre, përfshirë teknologjinë dhe pajisjet ndihmëse, dhe mbështetje për kujdestarët / prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Tyë nxirren udhëzime për stafin dhe partnerët për të mbështetur mësimin e fëmijëve në kushtet e mbylljes së shkollës, për ta bërë mësimin të arritshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. Duhet të adresohen çështje që shkojnë përtej të mësuarit. Për shumë fëmijë me aftësi të kufizuara, marrëdhëniet e bashkëmoshatarëve, perceptimi shoqëror dhe kompetenca sociale janë aspekte të rëndësishme të planeve të tyre të arsimit individual, të gjitha këto sfidohen në kontekstin e mbylljes së shkollës. Aktorët e arsimit duhet të sigurojnë që rikthimi në programet shkollore të përfshijë fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara, të merret në konsideratë rritja e hendekut në përfitimin e njohurive/arritje. Kjo mund të kërkojë rishikim/përmirësim të programeve.

7. Garantimi i parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës. Është e rëndësishme të garantohet që mekanizmat e raportimit dhe qasja në shërbimet e ndihmës për viktimat e dhunës të jenë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara. Të qenit proaktiv dhe inovativ për të kontaktuar me ata që janë të izoluar, përfshirë përmes rrjeteve vullnetare, ka provuar të jetë një masë

kryesore, duke siguruar që këshillimi në internet dhe zgjidhjet e tjera të bazuara në teknologji të jenë të arritshme dhe ti përgjigjen edhe nevojave të kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

8. Investim në zgjidhje të bazuara në komunitet: Mjediset institucionale/ institucionet/qendra rezidenciale janë bërë pikat/vatrat kryesore të COVID-19, duke marrë në konsideratë sfidat sistemike në këto mjedise. Personat me aftësi të kufizuara në mjediset institucionale përballen me rrezik të shtuar të infektimit dhe vdekjes nga COVID-19. Situata e tyre shoqërohet nga rreziqe më të mëdha, të tilla si abuzimi, izolimi dhe dhuna. Duhet të përgatiten institucionet për të parandaluar dhe reaguar ndaj infeksioneve të mundshme. Kjo përfshin prioritetet e testimit dhe masat parandaluese brenda institucioneve për të zvogëluar rreziqet e infeksionit, adresimin e mbipopullimit, izolimit dhe masave të distancimit fizik midis banorëve, modifikimin e orëve të vizitës, sigurimin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse të detyrueshme, dhe përmirësimi i kushteve të higjienës. Është e rëndësishme të garantohet që ata që infektohen ngavirusi, të marrin trajtim adekuat dhe kujdes shëndetësor dhe, kur është e nevojshme, të transferohen në spitale dhe / ose njësitë e kujdesit të urgjencës. Vëmendje e veçantë duhet t'u jepet personave me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione rezidenciale dhe fondet duhet të përdoren për të filluar, përshpejtuar dhe kompletuar strategjitë e deinstitutionalizimit dhe kalimin në zgjidhje me bazë komunitare. Kjo përfshin investimin dhe zhvillimin e shërbimeve mbështetëse dhe zbatimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse në nivelin lokal, siç është arsimi dhe kujdesi shëndetësor parësor, përfshirë rehabilitimin, si gur themeli për arritjen e objektivave SDG(OZhV) për personat me aftësi të kufizuara. Është e rëndësishme të zhvillohen dhe zbatohen planet e vazhdimësisë së shërbimeve egzistuese, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara me nevoja të mëdha mbështetjeje, duke marrë masa njëkohësisht edhe për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm ndaj COVID-19, për ta dhe për ofruesit e shërbimeve, gjatëofrimit të shërbimeve. Kjo përfshin udhëzime praktike dhe këshilla të përditësuara për kujdestarët joformal se si të mbështesin personat me aftësi të kufizuara në një mënyrë që të jetë e sigurt për të gjithë.

9. Nisja e dialogut dhe bashkëpunimit me shumë palë të interesuara: Kërkohet lidhja dhe bashkëpunimi ndër-sektorial për të adresuar natyrën shumëdimensionale të aftësisë së kufizuar dhe ndërhyrje ndër sektoriale. Përshtatjet konkrete në ndihmën humanitare mund të përfshijnë,

për shembull, përmirësimin e aksesit të objekteve që përdoren për larjen e duarve, shpërndarjen e mjeteve ndihmëse, artikujve dhe furnizimeve higjienike specifike për aftësinë e kufizuar; ndihmë për strehimin e përshtatur për individët në rrezik me qëllim që të ruhet distancimi fizik; sigurimi i mallrave, pajisjeve, ndihma në para dhe ofrimi i shërbimit të drejtpërdrejtë; sigurimi i marrëveshjeve alternative për shpërndarjen e ushqimit dhe artikujve jo-ushqimorë për familjet e personave me aftësi të kufizuara etj.

V. HAPAT KRYESORE PËR TË GARANTUAR NDËRHYRJE SEKTORIALE DHE MASA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR PARANDALIM DHE RIKUPERIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NGA COVID -19.

5.1 Procedurat e identifikimit dhe vlerësimit

- Caktoni punonjës komunitarë, për të identifikuar personat me aftësi të kufizuara.
- Integroni listën e shkurtër me pyetje (të Grupit të Uashingtonit) lidhur me aftësitë e kufizuara apo mjete të tjera domethënëse në mekanizmin e grumbullimit të të dhënave për të identifikuar personat me aftësi të kufizuara.
- Caktoni punëtorë nga komuniteti apo anëtarë të stafit të partnerëve për të identifikuar dhe regjistruar personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese mund të jenë burime të dobishme informacioni.
- Gjatë vlerësimeve të shpejta dhe me pjesëmarrje, përfshini pyetje specifike rreth përvojave të personave me aftësi të kufizuara. Bëjeni këtë që të identifikoni rreziqet specifike të mbrojtjes, nevojat specifike, dhe barrierat që pengojnë njerëzit të përftojnë asistencë.

- Konsultohuni me personat me aftësi të kufizuara për të përcaktuar se cilat mekanizma referuese dhe cilat forma të asistencës janë më të përshtatshme dhe të aksesueshme për ta.
- Trajtoni punonjësit e regjistrimit dhe ofroni udhëzime se si duhet të identifikojnë dhe regjistrojnë personat me aftësi të kufizuara.
- Mblidhni të dhënat lidhur me nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara.

5.2 Aksesi në Shërbime

- Identifikoni familjet që përfshijnë persona që kanë vështirësi në lëvizshmëri; në konsultim me familjet e tyre, vendosini ato pranë godinave dhe shërbimeve ose përcaktoni mjete që të mundësojnë aksesin e tyre në shërbime.
- Trajtoni partnerët dhe ofruesit vendorë të shërbimeve që të përfshijnë aftësitë e kufizuara, si dhe që të ndërtojnë kapacitetet e tyre për të zbatuar programe përfshirëse.
- Në këshillim me personat me aftësi të kufizuara përshtatni qendrat mjekësore, vendet e shpërndarjes së ndihmave, burimet e ujit, tualetet, shkollat, etj që t'i bëni ato të sigurt, të aksesueshme dhe të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara. (Shmangni barrierat apo rreziqet e pengesave, përfshini aksesin me rampa, dyer të gjëra, parrakë përgjatë shkallëve, hapësira për të kthyer karriget me rrota, dysheme jo të rrëshqitshme, etj.).
- Sigurohuni se shpërndarjet e ushqimit dhe ndihmave të tjera janë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara duke vendosur për këtë një sistem monitorimi të shpërndarjes. Nëse është e përshtatshme, mbani parasysh të krijoni radha të ndara, asistencë në transport, pako më të vogla, apo sisteme të dorëzimit në shtëpi. Bashkëpunoni me partnerët e shëndetit dhe ushqimit për të identifikuar nevojat e dietave specifike për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me probleme kronike të shëndetit.

- Konsultohuni me personat me aftësi të kufizuara për të identifikuar rreziqet specifike të mbrojtjes me të cilat përballen.
- Konsultohuni me personat me aftësi të kufizuara ndërsa projektoni infrastruktura të reja dhe vendosni se cilët artikuj duhet të përfshini në shpërndarje (për shembull, kuti më të lehta, etj). Konsultohuni paraprakisht që të shmangni përshtatje të kushtueshme më vonë.
- Punoni me autoritetet e shkollave dhe komuniteteve për të përmirësuar përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Përshtatni programet e arsimit atje ku është e nevojshme. Përfshini fëmijët dhe prindërit gjatë konsultimit.
- Konsultohuni me personat me aftësi të kufizuara për të identifikuar barrierat me të cilat ata përballen gjatë aksesit në shërbimet shëndetësore (duke përfshirë shëndetin publik, shëndetin seksual dhe riprodhues, shëndetin e nënave dhe fëmijëve, etj).

5.3 Shërbimet Mbështetëse

- Hartëzoni ofruesit e shërbimeve dhe partnerët e mundshëm (në nivel komunitar, vendor, dhe kombëtar, dhe në nivel kampi nëse është rasti) të cilët ofrojnë shërbime të specializuara, si rehabilitim ose aparate ndihmëse.
- Në këshillim me personat me aftësi të kufizuara, identifikoni ofruesit e shërbimeve, dakordohuni mbi mekanizmat e koordinimit, dhe vendosni mekanizmat referuese për aksesin në shërbime.
- Mos ndani personat me aftësi të kufizuara nga pjesëtarët e familjes së tyre apo personat mbështetës, ose nga aparatet ndihmëse, apo mjekimet (për shembull, gjatë shpërnguljes apo transportit).

- Konsultohuni me personat me aftësi të kufizuara dhe me komunitetin në përgjithësi, për të vlerësuar kapacitetin e komunitetit për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara të cilët janë vetëm dhe kanë nevojë për mbështetje.
- Identifikoni personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione, dhe sigurohuni se punonjësit dhe partnerët e caktuar për mbrojtjen e tyre po ndjekin rastet e tyre në vazhdimësi.

5.4. Parandalimi i abuzimit dhe shfrytëzimit

- Sigurohuni se të gjitha programet për parandalimin dhe reagimin ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual dhe dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore përfshijnë personat me aftësi të kufizuara.
- Vendosni, përmes punonjësve komunitarë dhe partnerëve të tjerë, sisteme për monitorimin dhe ndjekjen e situatave të personave me aftësi të kufizuara që janë në rrezik të shtuar për abuzim dhe shfrytëzim. Vini në zbatim mekanizmat e duhur referues.
- Trajtoni personat me aftësi të kufizuara, familjet e tyre, partnerët e parandalimit dhe reagimit ndaj dhunës seksuale dhe me bazë gjinore (DhS) dhe (DhBGj), dhe punëtorët e komunitetit se si të njohin, parandalojnë dhe të raportojnë rastet e dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit.

5.5 Përfshirja dhe ndarja e informacionit

- Përgatisni të gjitha mesazhet kyçe për popullatat , përfshirë ato për shëndetin, në formate të ndryshme (radio, gojarisht, broshura informuese në formate 'lehtësisht të lexueshme', tekste me simbole dhe imazhe, etj.).

- Sigurohuni se metodologjitë tuaja për këshillimin përfshijnë personat me aftësi të kufizuara dhe vatrën e tyre familjare. Përfshijini ata në vendim-marrje dhe në ngritjen e programeve, duke përfshirë hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve.

5.6 Ndërgjegjësimi dhe advokimi

- Informoni punonjësit dhe partnerët mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Theksoni se reagimet duhet të projektohen në këshillim me personat me aftësi të kufizuara për t'u siguruar se ato janë përfshirëse dhe të aksesueshme.
- Trajtoni punonjësit e organizatave humanitare, të ndihmës dhe ato zhvillimore dhe të partnerëve të tjerë mbi hapat praktik që mund të marrin për të përmirësuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen. Organizatat vendore të personave me aftësi të kufizuara, mund të jenë një burim i rëndësishëm trajnimi. Inkurajoni autoritetet të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në politikën dhe programet kombëtare, duke përfshirë programet kombëtare të mbrojtjes sociale.

5.7 Pjesmarrja

- Përfshini personat me aftësi të kufizuara në aktivitetet arsimore dhe të jetesës. Identifikoni mundësitë dhe trajnimet për ta, që i korrespondojnë përvojave dhe aftësive të tyre.
- Përfshini personat me aftësi të kufizuara në mekanizmat qeverisëse me bazë-komunitetin, si p.sh., komitetet e vlerësimit. Në rastet ideale, personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë strukturat e tyre dhe duhet të përfaqësohen në të gjitha strukturat me bazë-komunitetin.
- Angazhoni personat me aftësi të kufizuara në role udhëheqësie në komunitet, si vullnetarë në komunitet, lehtësues, etj. Për të arritur këtë, mund t'ju duhet të përshtasni kriteret dhe detyrat, ose të ofroni mbështetjen tuaj.

5.8 Mendimet Kryesore të Manaxhimit

- Vendosni në vend anëtarë stafi dhe burime të mjaftueshme që të mundësoni veprimtaritë për të adresuar hapësirat dhe barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara.
- Vlerësoni vazhdimisht programet dhe sigurohuni që atotë janë përfshirëse.
- Vendosni mekanizma monitorues për të gjitha hapat kryesor.
- Krijoni partneritete për të siguruar se shërbimet qeveritare dhe partnerët e tjerë kombëtar janë plotësisht të angazhuar. Kjo është thelbësore nëse duam që programet dhe mbështetja për personat me aftësi të kufizuara të jenë të qëndrueshme.

5.9 Burimet dhe partneritetet

Punonjësit

Punonjësit përfshijnë persona për Mbrojtjen, Mbrojtjen me bazë-komuniteti, asistencën dhe mbështetjen për shëndetin mendor dhe psikosocial.

Partnerët

Partnerët përfshijnë entitetet e OKB-së, OJQ Ndërkombëtare, OJQ kombëtare, përfshirë organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK), institucionet qeveritare dhe ministritë që punojnë për aftësinë e kufizuar ose ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Këto të fundit shpesh kanë aftësinë të ofrojnë shërbime asistence të shëndetit mendor dhe psikosociale.

Burimet

Do të nevojiten burime financiare për të planifikuar dhe vënë në zbatim shërbimet përkatëse, ndërhyrjet dhe programet.

Burime të tjera informacioni

- European Disability Forum - <http://www.edf-feph.org/covid19>
- European Commission - [COVID-19: 5 ways to help prevent the spread \(with international sign\)](#)
- Inclusion Europe - [Easy-to-read information about Coronavirus](#) available in many languages
- Self Advocacy Resource and Technical Assistance Center - [Plain language information by and for persons with disabilities](#)
- Swiss Public Health Authorities - [Coronavirus information in International Sign](#)
- International Disability Alliance
http://www.internationaldisabilityalliance.org/acessibility-campaign?fbclid=IwAR3XKrkp41_mq7jviEQëDy80ZwgPDqf_NpVjAzqiBMKXFnpJGC-uZVdmo4g